



KËSHILLI I EVROPËS  
KUSH JEMI  
ÇFARË BËJMË



## KUSH jemi

Këshilli i Evropës, me seli në ndërtesën e Palais de l'Europe në Strasburg, Francë, është organizata politike e parë dhe me shtrirje më të gjerë në Evropë.

E krijuar në 1949 nga 10 anëtarët themelues, tani mbulon pothuajse tërë kontinentin Evropian me 47 shtetet anëtare të saj, duke u bërë kështu një forum unik për të shprehur shqetësimet, shpresat dhe aspiratat e 800 milionë evropianëve.

## CILAT janë qëllimet tona

Qëllimi ynë kryesor ka qenë gjithmonë për të garantuar dinjitetin e popujve dhe qytetarëve të Evropës duke zbatuar respektimin e vlerave tona themelore: demokracia, të drejtat e njeriut dhe sundimi i ligjit. Ne besojmë se këto vlera janë themelet e një shoqërie tolerante dhe të civilizuar dhe të domosdoshme për stabilitetin evropian, zhvillimin ekonomik dhe kohezionin social.

Mbi bazën e këtyre vlerave themelore, ne përpiqemi të gjejmë zgjidhje të përbashkët të problemeve të mëdha të tilla si terrorizmi, krimi i organizuar dhe korrupsioni, krimi në internet, bioetika dhe klonimi, dhuna ndaj fëmijëve dhe grave dhe trafikimi i qenieve njerëzore. Bashkëpunimi midis të gjitha shteteve anëtare është e vetmja mënyrë për të zgjidhur problemet madhore me të cilat ballafaqohet shoqëria e sotme.

## ÇFARË bëjmë ne

Gama e gjerë e iniciativave të Këshillit të Evropës shpesh herë merr formën e konventave të hartuara për të sjellë ligjet e shteteve anëtare në harmoni me të ngushtë me njëri-tjetrin dhe me standardet e Këshillit. Aktualisht ka 200 të tilla. Më e njohura e këtyre është Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e cila përcakton të drejtat dhe liritë që shtetet anëtare janë të detyruara të sigurojnë për të gjithë individët brenda juridiksionit të tyre. Këto konventa janë plotësuar nga shumë rezoluta dhe rekomandime, drejtuar shteteve anëtare, të cilat luajnë një rol jetik në gjetjen e zgjidhjeve për problemet tona të përbashkëta.

# Si punojmë

## ■ Komiteti i Ministrave

Ky është organi vendimmarrës i Këshillit dhe është i përbërë nga ministrat e punëve të jashtme të secilit shtet anëtar ose zëvendësit e tyre me bazë në Strasburg. Politikat e tij janë baza e konventave ose marrëveshjeve dhe rekomandimeve Evropiane për shtetet anëtare.

## ■ Asambleja Parlamentare (PACE)

Kjo është organi diskutues dhe forca lëvizëse e Këshillit të Evropës. Parlamentarët nga shtetet anëtare debatojnë politikat për miratim të cilat paraqiten pranë qeverive për veprim. Anëtarët e saj emërohen nga parlamentet kombëtare të secilit shtet anëtar.

■ **Kongresi** është zëri i 200 000 rajoneve dhe bashkive të Evropës dhe siguron një forum ku përfaqësuesit e zgjedhur mund të diskutojnë problemet e përbashkëta, të mbledhin përvojat e tyre dhe të zhvillojnë politika. Ai punon për të forcuar demokracinë si dhe përmirësimin e shërbimeve në nivel lokal dhe rajonal.

■ **Konferenca e OJQ-ve Ndërkombëtare** përfshin rreth 400 OJQ Ndërkombëtare. Ajo siguron lidhje jetike midis politikanëve dhe publikut dhe sjell në Këshill zërin e shoqërisë civile. Puna e Këshillit përfiton shumë nga ekspertiza e OJQ-ve Ndërkombëtare dhe kontakti i tyre me qytetarët evropianë.

## ■ Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut

Është organ gjyqësor që siguron të drejtat e njeriut për të gjithë evropianët. Ajo është e hapur për shtetet dhe individët, pavarësisht nga kombësia, dhe juridiksioni i saj është i detyrueshëm për të gjitha palët kontraktuese.

■ **Komisioneri për të Drejtat e Njeriut** është një organ i pavarur përgjegjës për nxitjen, ndërgjegjësimin e arsimit dhe respektimin e të drejtave të njeriut në shtetet anëtare dhe sigurimin e pajtueshmërisë me konventat dhe rekomandimet e Këshillit të Evropës.

■ **Sekretari i Përgjithshëm**, i zgjedhur nga Asambleja Parlamentare për një mandat pesë-vjeçar, është përgjegjës për planifikimin strategjik dhe drejtimin e programit të punës dhe buxhetin e Këshillit si dhe mbikëqyr menaxhimin e ditë-pas-ditë të Organizatës.

## SIMBOLET tona

**Flamuri evropian** u zgjodh nga Këshilli i Evropës në vitin 1955. Ai tregon një rreth prej 12 yjesh ari në një sfond blu. Numri i yjeve është i pandryshueshëm, duke qenë dymbëdhjeta një numër simbolik i përsosmërisë. I njëjti flamur u miratua nga Komuniteti Evropian (tani Bashkimi Evropian) në vitin 1986.

**Himni Evropian**, i miratuar nga Këshilli në vitin 1972 dhe më vonë nga BE-ja, është një aranzhim muzikor, nga Herbert van Karajan, i preludit për "Odën e Gëzimit", nga Simfonia e Nëntë e Bethovenit.

## Por ka një ndryshim!

Edhe pse Këshilli i Evropës dhe Bashkimi Evropian tani ndajnë një flamur dhe një himn të përbashkët, rolet, funksionet dhe qëllimet e tyre janë mjaft të dallueshme. Këshilli i Evropës është një organizatë ndërqeveritare e cila sot ka 47 shtete anëtare. Ajo ka të bëjë kryesisht me mbrojtjen e të drejtave të njeriut, demokracinë dhe sundimin e ligjit.

Bashkimi Evropian aktualisht ka 27 shtete anëtare që kanë deleguar disa nga pavarësitë e tyre në mënyrë që vendimet mbi çështje specifike të interesit të përbashkët të mund të merren në mënyrë demokratike, në nivel evropian.

## A e dini ju se ...

... Këshilli i Evropës është një zonë ku dënimi me vdekje ndalohet? Falë vendimit të Asamblesë Parlamentare, që nga viti 1985, heqja e dënimit me vdekje tashmë është një parakusht për anëtarësimin në Këshillin e Evropës.

... që nga pilula me ë thjeshtë deri tek ilaçi më i sofistikuar, produktet farmaceutike të prodhuara dhe shitura në Evropë u nënshtrohen standardeve të rrepta, në sajë të punës së Drejtorisë Evropiane të Këshillit për Cilësinë e Medikamenteve.

... Këshilli i Evropës ishte organizata e parë që miratoi legjislacione në shumë fusha, duke përfshirë edhe Konventën për ndalimin e klonimit të qenieve njerëzore dhe Konventes për shtypjen e terrorizmit.



COUNCIL OF EUROPE  
CONSEIL DE L'EUROPE

## 47 shtetet anëtare:

Shqipëria, Andora, Armenia, Austria, Azerbajxhani, Belgjika, Bosnja dhe Hercegovina, Bullgaria, Kroacia, Qipro, Republika Çeke, Danimarka, Estonia, Finlanda, Franca, Gjeorgjia, Gjermania, Greqia, Hungaria, Islanda, Irlanda, Italia, Letonia, Lihtenshtajni, Lituania, Luksemburgu, Malta, Moldavia, Monaco, Mali i Zi, Holanda, Norvegjia, Polonia, Portugalia, Rumania, Federata Ruse, San Marino, Serbia, Republika Sllovake, Sllovenia, Spanja, Suedia, Zvicra, "Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë", Turqia, Ukraina, Mbretëria e Bashkuar.



## Për më shumë informacion

### **Marrëdhëniet me Publikun**

Informacioni

Tel.: +33 (0)3 88 41 20 33

Fax: +33 (0)3 88 41 27 45

Email: [infopoint@coe.int](mailto:infopoint@coe.int)

### **Shërbimi për Vizitorët Marrëdhëniet me Publikun**

Council of Europe, F-67075 Strasbourg Cedex

Tel.: +33 (0)3 88 41 20 29

Fax: +33 (0)3 88 41 27 54

Email: [visites@coe.int](mailto:visites@coe.int)

### **Botimet e Këshillit të Evropës**

F-67075 Strasbourg Cedex

Tel.: +33 (0)3 88 41 25 81

Fax: +33(0)3 88 41 39 10

Email: [publishing@coe.int](mailto:publishing@coe.int)

Website: <http://book.coe.int>

### **Zyra e Këshillit të Evropës në Tiranë**

Sheshi Skenderbej, Pallati i Kulturës

Kati i Parë, Tiranë, Shqipëri

Tel: +355 4 222 84 19

Fax: +355 4 224 89 40

E-mail: [informtirana@coe.int](mailto:informtirana@coe.int)

[www.coe.al](http://www.coe.al)

Zbuloni veprimtaritë e Këshillit të Evropës  
me faqen e saj:

**[www.coe.int](http://www.coe.int)**

